



P Z A P
I P Ž P

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.105/2025

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Arsim Hamzaj - kryesues, Kymete Kicaj e Skender Çoçaj - anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për shkak të mbajtjes së fushatës në institucione publike në Fushë Kosovë, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen me datë 09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur me 24.01.2025, mori këtë:

VE N D I M

REFUZOHEȚ e pabazuar ankesa A.nr.105/2025 e datës 21.01.2025, parashtruar nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 09.02.2025.

A r s y e t i m

Me datë 21.01.2025, PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), në të cilën theksohet se me date 20 janar, Qendra e Lëvizjes Vetëvendosje në Fushë Kosovë ka identifikuar se kandidati për deputet nga radhët e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Laurant Gojnovci kanë mbajtur takime me mësimdhënës në gjimnazin “Hivzi Sylejmani” në Fushë Kosovë në rrugën Aziz Zhilivoda” siç shihet në provat e bashkangjitura (postimi në llogarinë e tij në facebook). Mëtutje theksohet e i njëjti ka bërë fushatë në institucione publike me qëllim që të ndikojë në votues dhe njëkohësisht të votoj subjektin politik LDK dhe kandidatin Gojnovci.

Sipas parashtruesit të ankesës pretendon se i njëjti me këtë veprim ka shkelur nenin 36 i Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë si dhe Rregullorja Zgjedhore nr.07/2024 për Fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimin

Financiar. Ankesës ja ka bashkangjitur si provë: Postimin në facebook dhe fotografi. Kërkojnë nga PZAP-i, që duke u mbështetur në bazën ligjore dhe argumentet e lart cekura, si dhe duke u bazuar edhe në vendimin e PZAP-it, Anr.55/2025, të shqiptoj sankzionin me legjislacionin në fuqi.

Në përgjigje në ankesë subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës, LDK, thekson se pretendimet se kandidati për deputet nga radhët e LDK-së, në Fushë Kosovë, Laurant Gojnovci me veprimin e tij ka shkelur nenin 36 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme. konsiderojnë se ligjërisht nuk qëndrojnë dhe mund të jetë i diskutueshëm dhe argumentueshëm sipas provave të bashkangjitura. Në vazhdim të përgjigjes ka cekur sqarimet dhe argumentimet lidhur me ankesën në fjalë duke thënë se për vendin e mbajtjes së takimit janë plotësuar të gjitha kërkesat që kanë të bëjnë me informimin për tubimin në Komisionin Komunal Zgjedhor dhe Policinë e Kosovës sipas nenit 4 paragrafi 3 nënparagrafi 3.1 i rregullores zgjedhore Nr.07-2024 për Fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiar. Mëtutje njoftoi se ftesa për pjesëmarrje ka qenë publike përmes rrjeteve sociale dhe ka pasë për qëllim shpalosjen e programit për arsim dhe vendimi i mbajtjes ka qenë në përputhje edhe me nenin 4 paragrafi 2 i Rregullores Zgjedhore Nr.07/2024 për Fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiar me të cilën lidhet edhe tema e mbajtjes edhe për vendin ku është mbajt-tema arsimi e vendi i mbajtjes shkolla fillore. Po ashtu në përgjigjen e tyre kanë njoftuar se tubimi është mbajtur pas orarit të mësimit që nënkupton se kjo e rrezon edhe pretendimin e ankuesit e që është në përputhje me nenin 5 paragrafi 2, nënparagrafi 2.1 i Rregullores Zgjedhore Nr.07/2024 për Fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiar. Përgjigjes në ankesë i është bashkangjitur Formularin e Njoftimit për mbajtjen e Tubimit Politik si dhe Pëlqimin e lëshuar nga drejtoria për arsim në Fushë Kosovë.

Paneli, pasi që shqyrtoi dhe vlerësoi ankesën gjeti se:

Ankesë është e pabazuar

Bazuar në nenin 4 par.2 të Rregullores 07/2024 për Fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiar, e cila shprehimisht përcakton” *Subjektet politike të certikuara mund të mbajnë tubime në hapësirat publike, në institucionet arsimore, sportive dhe kulturore, ku nuk pengohet puna e rregullt e tyre dhe pasi që kjo të lejohet nga institucioni përkatës dhe KKZ”.*

Paneli me rastin e shikimit të shkresave të lëndës, vlerësoi se bazuar në Rregulloren Nr.07/2024 për Fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiar, *nëni 4 paragrafi 3 thekson se: se subjekti politik që dëshiron të organizojë një tubim politik, duhet ta dorëzojë formularin për njoftim për tubim në Komisionin Komunal të Zgjedhjeve (KKZ), jo më vonë se njëzetë e katër (24) orë para kohës kur është planifikuar mbajtja e tubimit me më pak se dyqind (200) pjesëmarrës dhe jo më vonë se dyzet e tetë (48) orë para kohës kur është planifikuar mbajtja e tubimit me më shumë se dyqind (200) pjesëmarrës, ndërsa nën paragrafi 4 thekson se: KKZ pas pranimit të formularit nga subjekti politik e regjistron në libër të protokollit dhe vendos për miratim*

sipas datës dhe kohë së pranimit të njoftimit". KKZ jo më vonë se ora 09:00 në ditën e tubimit e njofton policinë dhe zyrën për qëllime të monitorimit".

Paneli bazuar në përgjigjen e bashkangjitur nga Subjekti Politik LDK, nga formulari i bashkangjitur në përgjigje të LDK-së, ka vërtetuar faktin se subjekti politik në fjalë më datën 15.01.2025 ka dorëzuar formularin për njoftimin për mbajtjen e tubimit politik për datën 20 Janar 2025, në Shkollën e Mesme "Hivzi Sylejmani", në Fushë Kosovë, në ora 18:00, dhe lidhur me këtë ka marrë pëlqimin nga Drejtoria për Arsim në Fushë Kosovë. Poashtu është vërtetuar se Subjekti Politik LDK lidhur me mbajtjen e këtij tubimi ka dorëzuar formularin për njoftim lidhur me tubimin në Komisionin Komunal të Zgjedhjeve (KKZ), dhe mbi këtë arsyen Paneli ka gjetur se subjekti politik LDK në fjalë ka vepruar në përputhje me dispozitat e lartcekura, pasi që është vërtetuar se subjekti politik në fjalë ka marrë pëlqimin nga Drejtoria komunale e Arsimit si dhe nga ana e Komisionit Komunal të Zgjedhjeve (KKZ), dhe i njëjtë me tubimin e mbajtur nuk e ka penguar punën e rregullit të institucionit në fjalë.

Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se: "*vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse*", Paneli vlerësoi se pretendimet e palës ankuese se me mbajtjen e tubimit është penguar procesi i rregullt mësimor, janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoi, përfaktin se nga veprimet e përshkruara në ankesa dhe nga provat e ofruara si dëshmi parashtruesi i ankesës nuk ka arritur që të vërtetoj se këto veprime paraqesin shkelje të dispozitave të lartcekura të Rregullës Zgjedhore Nr.07/2024, dhe si të tilla të njëjtat i refuzoi si të pabazuara.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 par. 3, nenit 118 par. 1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.105/2025 më datën 24.01.2025

Kryesues i Panelit

Arsim Hamzaj



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4-të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.